



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA
DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .04.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

Objekti i Procedurës: “Shërbim për punime me autosondë ≥ 70 ton”

Kodi Përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV): 71356000-8 - Shërbime teknike,

VLERA E FONDIT LIMIT: 14,000,000 (katërmëdhjetë milion) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpétrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

OSE

Ne rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

Operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)
- OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 (ose ekuivalente)
- ISO 14001-2015 (ose ekuivalente)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon të sigurohet se ofertuesit përmbushin kërkesat e menaxhimit të cilësisë, standartet e sigurisë në punë, standartet e mbrojtjes së mjedisit. Këto kritere janë të lidhura ngushtë me proceset e punës që do të kryhen dhe me objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues te paraqese nje deklarate nepermjet se ciles garanton se ai eshte i afte dhe merr persiper kryerjen e te gjitha proceseve te punes te kerkuara nga AK me cilesi dhe profesionalizem, sipas specifikimeve teknike, termave te references dhe programeve te punes.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues te paraqese nje deklarate nepermjet se ciles garanton AK se merr persiper sigurimin e kushteve te sigurise ne pune per te gjitha stafin e angazhuar per zbatimin e kesaj kontrate, duke cilruar AK nga cdo pergjegjesi ne rastin e aksidenteve ne pune.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe dëshmojnë që marrin përsipër të kryejnë të gjitha proceset e punës së kërkuara për të përmbushur kontratën dhe gjithashtu sigurojnë AK se kontraktuesi do të marrë përsipër dhe sigurojë të gjitha kushtet e sigurimit në punë të punonjësve të angazhuar në zbatimin e kësaj kontrate dhe këto kritere janë në përputhje të plotë dhe proporcionale lidhur me kontratën objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 7 (shtatë) persona**, duke përfshirë edhe drejtuesin teknik.

Për të vërtetuar këtë duhet të paraqitet:

- Vërtetim të leshuar nga Administrata Tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për minimalisht muajin e fundit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë staf të mjaftueshëm për realizimin me sukses të kontratës së shërbimit me autosonde duke marre ne konsiderate numrin e punonjesve te brigades se remontit si dhe personelin inxhiniero-teknik.

2.3.6 Per drejtuesin teknik te shoqerise i cili duhet te jete me profesion inxhinier naftë, te paraqiten :

- Diploma e shkollës së lartë.
- Çertifikata e Lejes Profesionale per aktivitetin.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat inxhinieri i sipërcituar duhet të figurojë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues pjesë të stafit të ketë një specialist të certifikuar për mbikqyrjen dhe kontrollin e operacioneve të remontit dhe përdorimin e pajisjeve të kontrollit (BOP), të puseve.

Për të vërtetuar këtë duhet të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat specialisti i sipërpermendur duhet të figurojë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 4 gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nisur nga objekti i kontratës dhe termit e referencës, ofertuesit duhet të kenë domozdoshmerisht në stafin tyre një inxhinier naftë i cili do të drejtojë të gjitha proceset e remontit të analizojë programet e punës, etj. Gjithashtu me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësinë teknike dhe kanë staf të specializuar të inxhinierëve dhe specialistëve të brigadës së remontit për realizimin me sukses të kontratës së shërbimit me autosondë dhe këto kriterë janë vënë bazuar në termit e referencës dhe specifikimet teknike dhe janë në përputhje të plotë dhe proporcionale lidhur me kontratën objekt prokurimi.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 1(një) autosonde sipas kërkesave në specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, për kryerjen e proceseve të shërbimit për punime me autosonde në puse, në pronësi apo të marre me qira të vërtetuar si më poshtë :

Pronësia e autosondes të vërtetohet duke paraqitur lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt kollauidimi të vlefshëm, taksat vjetore.

Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk kanë leje qarkullimi Ofertuesi duhet të paraqesë kontratë notoriale të blerjes (nëse ka) të shoqëruar me fakturë tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit ose pajisjes.

Marrja me qira ose huapërdorja e autosondes, do të pranohet vetëm nëse kontrata/t e qiramarrjes ose të huapërdorjes janë të lidhura para noterit, me afat vlefshmerie i cili përfshin afatin e zbatimit të kësaj kontrate për këtë shërbim dhe të shoqëruara me dokumentacion (lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt kollauidimi të vlefshëm, taksat vjetore)

- Për autosondën duhet të paraqiten gjithashtu certifikatat e inspektimit (testimit) të cilat duhet të jenë sipas standartit API , ISO ose çdo standart ekuivalent përfshirë standartet Shqiptare.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e kryerjes së verifikimit në vend të mjeteve autosonde shërbimi me kullë me kapacitet ngritës ≥ 70 Ton dhe të pajisjeve të tjera për të konstatuar nëse ato përmbushin kërkesat teknike të kërkuara prej tij.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe këto kritere janë në përputhje të plotë dhe proporcionale lidhur me kontratën objekt prokurimi. Kriteri për disponimin e autosondës së shërbimit është vendosur në përputhje me objektin e prokurimit, pasi kontraktuesi bazuar në termat e referencës për këtë kontratë me autosondën e kërkuar do të kryejë të gjitha proceset e punës të remontit të puseve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit: